

Arsimi dhe ekonomia - në një linjë

Me anë të këtij projekti adresohet çështja e mungesës së lidhjes në mes të Arsimit të Lartë dhe ekonomisë në Kosovë dhe synohet të zhvillohen e të avancohen procedurat dhe mjetet për vlerësimin dhe përmirësimin e lidhjes në mes të kompetencave të zhvilluara nga institucioni i Arsimit të Lartë dhe kërkesave të tregut të punës në Kosovë

**EPOKA
ERE**

Lirije KLAIQI

PRISHTINË, 26 MAJ - Në Universitetin e Prishtinës (UP) është mbajtur Dita Informative lidhur me projektin "Kompetenca në Universitetin e Prishtinës" (CUP), e financuar nga Komisioni Evropian nëpërmjet programit TEMPUS.

Drejtues të këtij projekti kanë thënë se ky projekt adreson çështjen e mungesës së lidhjes në mes të Arsimit të Lartë dhe ekonomisë në Kosovë dhe synon të zhvillojë e t'i avancojë procedurat dhe mjetet për vlerësimin dhe përmirësimin e lidhjes në mes të kompetencave të zhvilluara nga institucioni i Arsimit të Lartë dhe kërkesave të tregut të punës në Kosovë. Po ashtu, synohet të krijohet një mjet për azhurnimin e lidhjes së strategjive me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për sigurim të cilësisë.

Rektori i Universitetit të Prishtinës (UP), Mujë Rugova, ka thënë se një ndër sfidat më të rëndësishme që përballet shoqëria kosovare është reformimi i UP-së në përputhje me nevojat e tij, procesin e Bolonjës dhe zhvillimin në Arsimin e Lartë.

Rugova ka shtuar se UP-ja është i vetmi universitet publik që ka më

së shumti njësi akademike dhe studentë, si dhe mbetet i përkushtuar të ofrojë cilësi dhe të punojë me profesionalizëm. Rugova ka falënderuar Komisionin Evropian për mbështetjen financiare të këtij projekti dhe për UP-në në përgjithësi.

Metodologjia e krijuar brenda këtij projekti do të bazohet në transferimin e njohurive nga universitetet partnere të BE-së dhe të adaptuar në bazë të kërkesave vendore.

Objektivat specifike të projektit janë: të themelohet një Qendër e Kompetencës dhe Observimit (COC), e cila do të shërbejë si një qendër kombëtare e transferit të diturisë dhe e trajnimeve; të instalohen terminale informative (sisteme të këshillimit të studentëve) për studentë, profesorë dhe vizitorë të UP-së në 32 lokacione strategjike të UP-së; të zhvillojë apo ta avancojë metodologjinë dhe mjetet për vlerësimin e lidhjes në mes të shkathtësive dhe kompetencave të zhvilluara nga institucioni i arsimit të lartë dhe kërkesave të tregut të punës në Kosovë dhe të zhvillojë rekomandime për adaptimin e kurrikulave në UP; të kryejë analiza të diturisë të bazuara në dy pilot-programe të studimeve që të shërbejnë më vonë si shembuj të mirë praktikë.